

ALBANIAN

TÚSLA

An Ghníomhaireacht um  
Leanaí agus an Teaghlach  
Child and Family Agency

Një udhëzues i shkurtër i Tusla:  
**Për prindërit e sapoardhur  
në Irlandë**



[www.tusla.ie](http://www.tusla.ie)

**CYPSC**  
CHILDREN & YOUNG PEOPLE'S SERVICES COMMITTEES

# Përmbajtja

Hyrje	3
Cilat janë të drejtat e fëmijëve në Irlandë	4
Përgjegjësitë e prindërve dhe kujdestarëve	4
Mbikëqyrja e fëmijëve	4
Shërbimet e Mbështetjes së Familjes	5
Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve	6
Çfarë duhet të bëni nëse jeni dëshmitar i një shqetësimi për një fëmijë	6
Si të raportoj një shqetësim për një fëmijë?	6
Sistemi i kujdesit për fëmijët në Irlandë	8
Sistemi arsimor në Irlandë	9
Regjistrimi në shkollë	9
Informacione të tjera që mund të jenë të dobishme	10
Mosha e dhënies së pëlqimit për seks	10
Në çfarë moshe mund të martohen njerëzit në Irlandë?	10
Mosha ligjore për të punuar	10
E drejta për identitet gjinor	10
Alkooli dhe ligji	10
Shërbimet e Akomodimit të Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPAS)	10
Dhuna në familje dhe dhuna mbi bazë gjinore	11
Lista e organizatave që punojnë me të rinjtë në Irlandë	12
Kontakte të tjera të dobishme	13

# Hyrje

**Ky udhëzues është zhvilluar nga Agjencia për Fëmijët dhe Familjen (Tusla), me të dhëna nga familjet që kanë mbërritur së fundmi në Irlandë dhe ky botim dhe ribotim i rishikuar (2023) është financuar nga iniciativa e Komiteteve të Shërbimeve për Fëmijët dhe të Rinjtë (CYPSC).**

Në këtë dokument përfshihen disa udhëzime praktike që shpresojmë se do t'ju ndihmojnë të navigoni në vitet e para të jetës së një fëmije gjatë qëndrimit në Irlandë, nga kujdesi për fëmijët e moshës parashkollore dhe sistemi arsimor deri te mbikëqyrja e fëmijëve dhe shërbimet mbështetëse të familjes. Ne kemi përfshirë edhe disa seksione të tjera në këtë dokument që shpresojmë se do t'ju ndihmojnë.



# Cilat janë të drejtat e fëmijëve në Irlandë

**Të drejtat e fëmijëve përfshijnë të drejtën për shëndet, arsim, jetë familjare, lojë dhe argëtim, një standard të përshtatshëm jetese dhe të drejtën për t'u mbrojtur nga çdo lloj abuzimi dhe dëmtimi. Të drejtat e fëmijëve mbulojnë vitet e hershme që nga lindja e fëmijës, deri në momentin kur fëmija arrin moshën madhore në Irlandë kur mbush 18 vjeç - përveç rasteve kur është i martuar ligjërisht.**

## Përgjegjësitë e prindërve dhe kujdestarëve

Në Irlandë, prindërit dhe kujdestarët kanë përgjegjësinë kryesore për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të tyre. Në disa raste, për një sërë arsyesh, prindërit mund të mos jenë në gjendje të ofrojnë kujdes dhe mbrojtje për fëmijët e tyre dhe ndonjëherë mund të nevojitet ndihmë më intensive për t'i mbajtur fëmijët të sigurt nga dëmtimi. Në këto rrethana shteti irlandez mund të ndërhyjë me synimin për të ndërtuar fuqitë ekzistuese të familjes. Agjenci të ndryshme shtetërore ofrojnë mbështetje për të ndihmuar familjet të kapërcejnë vështirësitë dhe për t'u siguruar që fëmija të jetë i sigurt.

Në Irlandë, është e rëndësishme të kihet parasysh se goditja fizike me shuplakë ose goditja e një fëmije nuk lejohet nga asnjë i rritur, as në shtëpi, as në shkollë. Në Irlandë, të gjitha format e ndëshkimit trupor të fëmijëve janë kundër ligjit. Kjo mund të trajtohet si krim dhe t'i referohet An Garda Síochána (policisë irlandeze).

## Mbikëqyrja e fëmijëve

Shumica e prindërve ose kujdestarëve duhet të kalojnë pak kohë larg fëmijëve të tyre, qoftë për periudha më të gjata kur shkojnë në punë ose periudha më të shkurtra për aktivitete shoqërore. Fëmijët nuk duhet të lihen kurrë vetëm, kështu që prindërit duhet të marrin masa që për fëmijën e tyre të kujdesen miq të besuar ose një shërbim ose kujdestar për kujdesin e fëmijëve.

Nuk ka një moshë të caktuar në të cilën është e ligjshme të lihen fëmijët vetëm në shtëpi, pasi varet nëse fëmija është mjaft i pjekur për t'u lënë vetëm. Në Irlandë, fëmijët nën 14 vjeç nuk shihen se janë shihen se janë mjaft të pjekur për t'u lënë vetëm ose pa mbikëqyrje. Për adoleshentët më të rritur, është vendim i prindit ose kujdestarit, bazuar në fëmijën, nivelin e pjekurisë dhe rrethanat e tyre të jetesës.

Fëmijët e arrijnë pjekurinë në moshë të ndryshme, por më poshtë është një udhëzues i përafërt se kur fëmijët mund të qëndrojnë vetëm në shtëpi:

### A mund ta lë foshnjën time vetëm në shtëpi?

Jo, as për disa minuta.

### A mund ta lë fëmijën tim të vogël vetëm në shtëpi?

Fëmijët e vegjël nuk duhet të lihen kurrë vetëm në shtëpi, as për një kohë të shkurtër.

### A mund ta lë fëmijën tim të rritur vetëm në shtëpi?

Rekomandohet që fëmijët nën moshën 14 vjeç të mos lihen vetëm në shtëpi për më shumë se një kohë shumë të shkurtër.

### A mund ta lë adoleshentin tim vetëm në shtëpi?

Adoleshentët mbi 16 vjeç mund të lihen vetëm në shtëpi.

### Çfarë moshe duhet të ketë një dado?

Nëse keni nevojë të përdorni një dado, duhet të siguroheni gjithmonë se ato janë mbi 16 vjeç dhe duhet t'i kërkonin dy referenca për të kontrolluar se janë mjaft të përgjegjshme për t'u lënë me fëmijët tuaj. (*Globe All IPIP Information Pack, 2010*)

Nëse një fëmijë lihet vetëm dhe pa mbikëqyrje, veçanërisht në mjedise në grup, dhe ka shqetësime rreth kësaj, atëherë në këto rrethana Punonjësit Socialë të Tusla mund të ndërhyjnë për të këto shqetësime dhe për të mbështetur familjen.

## Shërbimet e Mbështetjes së Familjes

Jeta familjare nuk është gjithmonë e lehtë, veçanërisht në kohë të vështira tranzicioni dhe pasigurie. Shërbimet e Mbështetjes së Familjes të Tusla mund të ndihmojnë. Thjesht të keni dikë me të cilin të flisni për problemin tuaj mund të jetë mënyra më e lehtë për të filluar trajtimin

e tij. Ka shumë grupe mbështetëse për të rriturit, adoleshentët, fëmijët dhe kujdestarët që u japin njerëzve mundësinë të tregojnë historitë e tyre dhe të mbështesin njëri-tjetrin. Shërbimet e Mbështetjes së Familjes përgjithësisht u ofrohen familjeve në shtëpitë dhe komunitetet e tyre.

Sido që të jenë rrethanat tuaja, Tusla ofron një sërë shërbimesh që ofrojnë këshilla dhe mbështetje për familjet. Kjo përfshin punonjësit e mbështetjes së familjes, punonjësit socialë, punonjësit e të rinjve, Qendrat e Burimeve Familjare, grupet mbështetëse dhe shërbimet e këshillimit. Këto shërbime mund të aksesohen nëpërmjet Qendrave lokale të Burimeve Familjare dhe Rrjeteve të Mbështetjes së Fëmijëve dhe Familjes. Këto lloj shërbimesh i ndihmojnë familjet të përballen me çështje të vështira, sigurohen që fëmijët të kenë një mjedis stabil për të jetuar dhe ofrojnë mbështetje për prindërit që e kanë të vështirë.

**Qendrat e Burimeve Familjare** janë në qendër të shumë komuniteteve dhe janë një burim i madh informacioni, këshillash dhe mbështetjeje. Ata gjithashtu ofrojnë një gamë të gjerë programesh të mbështetjes së familjes dhe prindërimit: <https://www.familyresource.ie/>



## Kontaktet e Mbështetjes së Familjes

<b>Rrjetet Mbështetëse të Fëmijëve dhe Familjes</b>	<a href="https://www.tusla.ie/familysupport/">https://www.tusla.ie/familysupport/</a>
<b>Mbështetja për prindërimin</b>	<a href="https://www.tusla.ie/parenting-24-seven/">https://www.tusla.ie/parenting-24-seven/</a>
<b>Ekipet Lokale të Punës Sociale</b>	<a href="https://www.tusla.ie/get-in-touch/duty-social-work-teams/">https://www.tusla.ie/get-in-touch/duty-social-work-teams/</a>
<b>Komitetet e Shërbimeve për Fëmijët dhe të Rinjtë (CYPSC)</b>	<a href="https://www.cypsc.ie/contact.36.html">https://www.cypsc.ie/contact.36.html</a>
<b>Faqja e Internetit e qeverisë irlandeze për mbështetjen e prindërve</b>	<a href="https://www.gov.ie/en/publication/91ea0-support-and-advice/#local-supports-for-parents">https://www.gov.ie/en/publication/91ea0-support-and-advice/#local-supports-for-parents</a>

### Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve

Agjencia për Fëmijët dhe Familjen (Tusla) është përgjegjëse në Irlandë për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve. An Garda Síochána (policia irlandeze) ka gjithashtu përgjegjësi për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve sipas ligjit irlandez.

Të gjithë janë përgjegjës në Irlandë për raportimin nëse fëmijët me të cilët janë në kontakt mund të vuajnë nga abuzimi ose neglizhimi.

#### Çfarë duhet të bëni nëse jeni dëshmitar i një shqetësimi për një fëmijë

Në Irlandë, ka një detyrim ligjor për të gjithë që të raportojnë çdo shqetësim për një fëmijë. Tusla duhet të informohet gjithmonë nëse keni arsye të forta për t'u shqetësuar se një fëmijë mund të ketë qenë, është ose ka rrezik për t'u abuzuar ose neglizhuar. Kjo përfshin gjithashtu edhe nëse jeni dëshmitar i diçkaje në një mjedis grupor ose në një qendër akomodimi.

Nëse shqetësoheni për mirëqenien dhe sigurinë e një fëmije, duhet të kontaktoni pa vonesë Ekipet e Punës Sociale në Detyrë të Tusla/ Pikat e dedikuara të kontaktit:

<https://www.tusla.ie/get-in-touch/duty-social-work-teams/>

#### Si të raportoj një shqetësim për një fëmijë?

Ju mund ta raportoni shqetësimin tuaj personalisht, me telefon ose me shkrim në shërbimin lokal social në detyrë në zonën ku jeton fëmija. Këtu mund të gjeni detajet e kontaktit për ekipet e punës sociale në Tusla:

<https://www.tusla.ie/children-first/contact-a-social-worker3/>

### Shqetësimet për mbrojtjen ose mirëqenien e fëmijëve mund të përfshijnë:

- Dëshmi për një dëmtim ose sjellje, që është në përputhje me abuzimin dhe nuk ka gjasa të jetë shkaktuar në ndonjë mënyrë tjetër
- Çdo shqetësim në lidhje me abuzimin e mundshëm seksual
- Shenja të vazhdueshme që një fëmijë vuan nga neglizhenca emocionale ose fizike
- Një fëmijë që thotë ose tregon me mënyra të tjera se ai ose ajo është abuzuar
- Pranimi ose treguesit nga një i rritur ose një fëmijë për një abuzim të supozuar që ata kanë kryer
- Një rrëfim nga një person që pa fëmijën duke u abuzuar

Çdo pyetje ose shqetësim në lidhje me fëmijët jashtë orarit normal të punës mund të raportohet menjëherë te An Garda Síochána:

<https://www.garda.ie/en/contact-us/station-directory/>



# Sistemi i kujdesit për fëmijët në Irlandë

## Kujdesi për fëmijët e moshës parashkollore

Në Irlandë, në përgjithësi, fëmijët nën moshën 6 vjeç kanë akses në një formë të edukimit të fëmijërisë së hershme. Ekzistojnë dy skema kryesore për të ndihmuar familjet me këtë:

1. Programi i Kujdesit dhe Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (ECCE)
2. Skema Kombëtare e Kujdesit për Fëmijët (NCS)

## ECCE - Programi Falas Parashkollor

Programi ECCE është një program parashkollor falas i disponueshëm për të gjithë fëmijët për dy vjet para fillimit të shkollës fillore. Ky zgjat nga shtatori deri në qershor për tre orë në ditë për pesë ditë në javë.

Fëmijët janë të përshtatshëm për këtë program nga shtatori pasi të kenë mbushur 2 vjeç e 8 muaj. Kjo skemë përfundon në moshën 5 vjeç e 6 muaj. Për çdo pyetje mbi skemën ECCE, ju lutemi kontaktoni: [eyqueries@dca.ie](mailto:eyqueries@dca.ie)

## Skema Kombëtare e Kujdesit për Fëmijët

Skema Kombëtare e Kujdesit për Fëmijët (NCS) është një skemë shtesë e cila "mbështjell" skemën ECCE. Ajo siguron mbështetje financiare shtesë për kostot financiare të kujdesit për fëmijët për orët e kaluara jashtë arsimit parashkollor. Ekzistojnë tre lloje referimesh që mund të bëhen për këtë skemë:

1. Universale,
2. Sipas vlerësimit të të ardhurave dhe
3. Referimet e sponsorëve.

Për informacion mbi 1. Universale dhe 2. Referimet sipas vlerësimit të të ardhurave: Kontaktoni: [www.ncs.gov.ie](http://www.ncs.gov.ie) ose **+353 1 906 8530**.

**Referimet e sponsorëve:** Nëse ju është dhënë Mbrojtja e Përkohshme, Skema Kombëtare e Kujdesit për Fëmijët (NCS) mund të mbulojë koston e plotë të kujdesit për fëmijët sipas marrëveshjeve të sponsorizimit të NCS. Ky Referim sponsori duhet të bëhet nga një agjenci sponsorizuese, një prej së cilave është Tusla.



## Çfarë do të thotë një Referim sponsori nga Tusla për mua si prind?

Personi që punon me ju nga Tusla do të plotësojë një formular referimi për ju për këtë lloj referimi. Ky formular do t'ju tregojë numrin e orëve të kujdesit për fëmijët që mund të përdorni në javë. Koha maksimale e disponueshme në javë është 45 orë. Ju mund t'i përdorni këto orë me një shërbim të kujdesit për fëmijë të regjistruar pranë Tusla. Formulari i referimit do t'ju tregojë gjithashtu se sa do të zgjasë referimi. Në përgjithësi, kjo do të jetë për një vit.



## Ku mund të marr më shumë informacion?

Ekipi i Sponsorëve të NCS mund të kontaktohet me telefon në **+353 1 906 8535** nga ora 9 e mëngjesit deri në 5 pasdite, nga e hëna deri të premtën ose me email në [sponsors@ncs.gov.ie](mailto:sponsors@ncs.gov.ie)

Ju mund të përdorni [funksionin e kërkimit të kujdesit për fëmijët për](#) të kërkuar listën e plotë të ofruesve të shërbimit të kujdesit për fëmijët të NCS në [www.ncs.gov.ie](http://www.ncs.gov.ie)



## Komitetet e qytetit/kontesë për kujdesin për fëmijët

Këto gjithashtu mbështesin dhe ndihmojnë familjet me ofrues të kujdesit për mësimin e hershëm. Informacioni mund të gjendet në: [www.mycce.ie](http://www.mycce.ie). Fëmijët nga moshë 4 deri në 18 vjeç do të mbështeten për të hyrë në arsimin publik fillor ose pas-fillor të ofruar nga shteti sipas rastit.



# Sistemi arsimor në Irlandë

## Regjistrimi në shkollë

Në Irlandë, fëmijët duhet të shkojnë në shkollë nga mosha 6 vjeç deri në moshën 16 vjeç.

Vitet e para të shkollës quhen vitet e **“Shkollës fillore”**. Ky arsim është falas dhe të gjithë fëmijët janë të detyruar ligjërisht të marrin pjesë. Fëmija duhet të jetë së paku 4 vjeç në fillim të vitit shkollor për të filluar shkollën. Në Irlandë, prindi ose kujdestari duhet të sigurohet që fëmija të shkojë në shkollë çdo ditë. Prindi ose kujdestari duhet gjithashtu t'i tregojë shkollës dhe të japë arsye nëse fëmija do të mungojë. Shkolla duhet të raportojë te Shërbimi i Mbështetjes Arsimore Tusla, nëse fëmija juaj ka munguar njëzet ditë ose më shumë gjatë vitit shkollor ose nëse është e shqetësuar se fëmija juaj po mungon shumë në shkollë. Ju lutemi gjeni informacione për frekuentimin e shkollës për fëmijët: [https://www.tusla.ie/uploads/content/english\\_leaflet.pdf](https://www.tusla.ie/uploads/content/english_leaflet.pdf)

Faza tjetër e shkollës në Irlandë quhet **“Shkolla e mesme ose pas-fillore”** dhe është për nxënësit e moshës 12 deri në 18 vjeç. Frekuentimi në shkollë është i domosdoshëm për nxënësit e moshës nën 16 vjeç. Shumica e shkollave të mesme nuk kërkojnë tarifa.

Fëmijët nga mosha 4 deri në 18 vjeç do të mbështeten për të hyrë në arsimin publik fillor ose të mesëm të ofruar nga shteti. Që fëmija juaj të fillojë në arsim, ju mund t'i drejtoheni shkollës suaj lokale dhe ata do të japin informacion se si të regjistrohëni.

Lista e shkollave mund të gjendet këtu:

<https://www.gov.ie/en/directory/category/495b8a-schools/>

## Ekipet Rajonale të Arsimit dhe Gjuhës

**(REALTs)** do të mbështesin familjet që kërkojnë Mbrojtje Ndërkombëtare dhe fëmijët e të cilave kërkojnë regjistrim në shkollë. Familjet që kanë vështirësi për të gjetur një vend në shkollë, mund të kontaktojnë me ekipin e tyre lokal REALT këtu:

<https://www.gov.ie/en/publication/48639-information-for-schools-ukraine/>

## Stafi i Shërbimit Mbështetës Arsimor

**Tusla (TESS)** janë anëtarët kryesorë të ekipeve REALT dhe gjithashtu do të ndihmojnë familjet nëse kanë vështirësi për të gjetur një vend në shkollë:

<https://www.tusla.ie/tess/get-in-touch/> ose **+353 1 7718636 / +353 1 7718586**



## Informacione të tjera që mund të jenë të dobishme

### Mosha e dhënies së pëlqimit për seks

Në Irlandë, ligjërisht mund të jepni pëlqim për seksin në moshën 17 vjeç. Kjo është një pavarësisht nga orientimi juaj seksual ose me cilën ose cilat gjini jeni seksualisht aktiv. Më shumë informacion mbi këtë mund të gjeni në:

<https://www.citizensinformation.ie/en/birth-family-relationships/children-s-rights-and-policy/>

### Në çfarë moshe mund të martohen njerëzit në Irlandë?

Mosha në të cilën njerëzit mund të martohen në Irlandë është 18 vjeç. Nëse një person është nën moshën 18 vjeç, ai duhet të shkojë në Gjykatë për të marrë një "urdhër përjashtimi" që të lejohet martesat.

### Mosha ligjore për të punuar

Në Irlandë, fëmijët nga 14 deri në 18 vjeç ndonjëherë futen në punë me kohë të pjesshme gjatë verës ose jashtë orarit të shkollës. Të rinjtë që ndjekin kolegjin ndonjëherë punojnë me kohë të pjesshme dhe e përshtatin këtë me studimet e tyre.

Një i ri mund të punojë me kohë të pjesshme nga mosha 14 vjeç dhe me kohë të plotë nga mosha 16 vjeç. Megjithatë, për sa kohë janë nën 18 vjeç, ka kufizime se sa kohë mund të punojnë të rinjtë dhe llojin e punës që mund të bëhet.

Për më shumë informacion rreth punës nën moshën 18 vjeç, mund të gjeni informacion në:

[www.citizensinformation.ie](http://www.citizensinformation.ie)

### E drejta për identitetin gjinor

Në Irlandë mund ta identifikoni gjininë tuaj në çdo moshë. Për të njohur ligjërisht gjininë tuaj, duhet të jeni mbi 18 vjeç. Më shumë informacion mbi këtë mund të gjeni në:

<https://www.citizensinformation.ie/en/birth-family-relationships/legal-recognition-of-preferred-gender/>

### Alkooli dhe ligji

Duhet të jeni 18 vjeç ose më shumë për të blerë alkool në Irlandë. Është e paligjshme të shërbesh, të blesh ose t'i japësh alkool një personi që është nën 18 vjeç. Pirja e alkoolit në shumicën e vendeve publike nuk lejohet në Irlandë.

### Shërbimet e Akomodimit të Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPAS)

Nëse keni nevojë për akomodim nga qeveria, kontaktoni sportelin e ndihmës të IPAS për mbështetje (e disponueshme 24 orë) në: **ipasinbox@equality.gov.ie**

### Për informacion të përgjithshëm:

- The Irish Refugee Council: [www.irishrefugeecouncil.ie](http://www.irishrefugeecouncil.ie)
- Citizens Information: <https://www.citizensinformation.ie/en/moving-country/asylum-seekers-and-refugees/>

## Dhuna në familje dhe dhuna mbi bazë gjinore

Dhuna në familje nuk është e pranueshme dhe është kundër ligjit në Irlandë. Mund ta raportoni te **An Garda Síochána** nëse ju ndodh juve ose familjes suaj. Dhuna në familje i referohet përdorimit të forcës fizike, forcës emocionale ose kërcënimit për forcë fizike, duke përfshirë dhunën seksuale në marrëdhëniet e ngushta të të rriturve.

Ajo përfshin dhunën e ushtruar nga një bashkëshort, partner, bir, bijë ose çdo person tjetër që ka lidhje të ngushtë ose jeton me viktimën.

Sipas ligjit të dhunës në familje në Irlandë, ekzistojnë mbrojtje duke marrë urdhra sigurie dhe urdhra ndalimi (për të ndaluar personin që t'ju afrohet juve ose shtëpisë suaj). Më shumë informacion mbi këtë është në dispozicion nga Legal Aid Board Ireland: [www.legalaidboard.ie](http://www.legalaidboard.ie)

## Linja e Ndhmës dhe Shërbimet e Krizave

<b>Garda Síochána (Policia irlandeze)</b> - 24 orë	999/112 ose stacioni juaj lokal i Garda <a href="https://www.garda.ie/en/">https://www.garda.ie/en/</a>
<b>Linja Kombëtare e Ndhmës për Krizën e Përdhunimit</b> - 24 orë	1800 778888 <a href="https://www.drcc.ie/services/">https://www.drcc.ie/services/</a>
<b>Linja e Ndhmës për Gratë</b> - 24 orë	1800 341900 <a href="https://www.womensaid.ie/">https://www.womensaid.ie/</a>
<b>Men's Development Network</b>	1800 816588 <a href="https://mensnetwork.ie/">https://mensnetwork.ie/</a>
<b>Men's Aid Ireland</b>	01 554 3811 <a href="https://www.mensaid.ie/">https://www.mensaid.ie/</a>



# Lista e organizatave që punojnë me të rinjtë në Irlandë

<b>Clare Immigrant Support Centre (CISC)</b>	<a href="http://www.clareimmigrantsupportcentre.com">www.clareimmigrantsupportcentre.com</a>
<b>Crosscare</b> <i>(Shërbimi i Informimit dhe Avokimit për Refugjatët)</i>	<a href="http://www.crosscare.ie">www.crosscare.ie</a> <a href="http://www.livinginireland.ie">www.livinginireland.ie</a> Email: <a href="mailto:refugeeservice@crosscare.ie">refugeeservice@crosscare.ie</a>
<b>Doras Luimní</b> <i>(Përkrahja e të drejtave të të gjithë migrantëve që jetojnë në Limerick dhe në rajonin e gjerë të Mid-West)</i>	<a href="http://www.dorasluimni.org">www.dorasluimni.org</a>
<b>Focus Ireland</b> <i>(Të ndihmojmë familjet, të rinjtë dhe fëmijët në rrezik ose të prekur nga mungesa e strehimit)</i>	<a href="http://www.focusireland.ie">www.focusireland.ie</a>
<b>Immigrant Council of Ireland</b>	<a href="http://www.immigrantcouncil.ie">www.immigrantcouncil.ie</a>
<b>Klinika e Mbështetjes së Imigrantëve në Kilkenny</b>	<a href="http://www.frmcgrathcentre.ie/immigrant-support-clinic/">www.frmcgrathcentre.ie/immigrant-support-clinic/</a>
<b>Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)</b> <i>(dega irlandeze e organizatës)</i>	<a href="https://ireland.iom.int/">https://ireland.iom.int/</a>
<b>Irish Refugee Council</b>	<a href="http://www.irishrefugeecouncil.ie">www.irishrefugeecouncil.ie</a>
<b>Jesuit Refugee Service (JRS)</b> <i>(Ofrojnë disa shërbime mbështetëse të drejtpërdrejta për refugjatët)</i>	<a href="http://www.jrs.ie">www.jrs.ie</a>
<b>Mayo Intercultural Action</b>	<a href="https://www.mayo.ie/en-ie/living-in-mayo/living-services/mayo-intercultural-action">https://www.mayo.ie/en-ie/living-in-mayo/living-services/mayo-intercultural-action</a>
<b>Nasc</b> <i>(Organizatë që punon për të drejtat e njeriut, drejtësinë sociale dhe barazinë)</i>	<a href="http://www.nascireland.org">www.nascireland.org</a>
<b>New Communities Partnership (NCP)</b> <i>(Një rrjet i pavarur kombëtar prej 175 grupesh të udhëhequra nga emigrantët, i përbërë nga 65 kombësi me shërbime në e Kontenë e Dublinit dhe Kontenë Cork me shtrirje në qytete të tjera)</i>	<a href="http://www.newcommunities.ie">www.newcommunities.ie</a> Email: <a href="mailto:info@newcommunities.ie">info@newcommunities.ie</a>

<p><b>Ruhama</b> (Një organizatë që punon me gratë e prekura nga prostitucioni dhe forma të tjera të shfrytëzimit seksual )</p>	<p><a href="http://www.ruhama.ie">www.ruhama.ie</a></p>
<p><b>SPIRASI</b> (Punon me azilërkues, refugjatë dhe grupe të tjera të marginalizuara migrantësh)</p>	<p><a href="http://www.spirasi.ie">www.spirasi.ie</a></p>
<p><b>Tralee International Resource Centre (TIRC)</b></p>	<p><a href="http://www.tirc.ie">www.tirc.ie</a></p>
<p><b>UNHCR</b> (Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët)</p>	<p><a href="http://www.unhcr.org/en-ie">www.unhcr.org/en-ie</a></p>
<p><b>Kontakte të tjera të dobishme</b></p>	
<p><b>An Garda Síochána (Policia irlandeze)</b> (Shërbimi kombëtar i policisë në Irlandë)</p>	<p><a href="https://www.garda.ie/en/contact-us/station-directory/">https://www.garda.ie/en/contact-us/station-directory/</a></p>
<p><b>Barnardos</b> (Organizatë që punon me fëmijët dhe familjet)</p>	<p><a href="http://www.barnardos.ie">www.barnardos.ie</a></p>
<p><b>Childrens Rights Alliance</b> (Informacion mbi të drejtat e fëmijëve dhe ligjin në Irlandë)</p>	<p><a href="http://www.childrensrights.ie">www.childrensrights.ie</a></p>
<p><b>Komitetet e Shërbimeve për Fëmijët dhe të Rinjtë</b> (Informacion dhe shërbime për të rinjtë)</p>	<p><a href="http://www.cypsc.ie">www.cypsc.ie</a></p>
<p><b>Citizens Information</b> (Informacion mbi të drejtat dhe ligjet në Irlandë)</p>	<p><a href="http://www.citizensinformation.ie">www.citizensinformation.ie</a></p>
<p><b>Komitetet e qytetit dhe kontesë për kujdesin për fëmijët</b> (Ndihej me vendet e kujdesit të fëmijëve të moshës parashkollore)</p>	<p><a href="http://www.myccc.ie">www.myccc.ie</a></p>
<p><b>Departamenti i Fëmijëve, Barazisë, Aftësisë të Kufizuara, Integritit dhe Rinisë</b> (Departamenti qeveritar i Irlandës që ka përgjegjësinë për fëmijët)</p>	<p><a href="http://www.gov.ie/dcediy">www.gov.ie/dcediy</a> Telefon: +353 1 6473000 Email: <a href="mailto:contact@equality.gov.ie">contact@equality.gov.ie</a></p>

<p><b>Departamenti i Mbrojtjes Sociale</b>  <i>(departamenti qeveritar i Irlandës që ka përgjegjësinë për të gjitha pagesat e mirëqenies sociale dhe të drejtat për të rriturit dhe fëmijët)</i></p>	<p><a href="http://www.gov.ie/en/organisation/departament-of-social-protection">www.gov.ie/en/organisation/departament-of-social-protection</a></p>
<p><b>Bordet e Arsimit dhe Formimit Profesional të Irlandës (ETBI)</b>  <i>(Informacion mbi arsimin dhe vendet në shkollë)</i></p>	<p><a href="http://www.etbi.ie">www.etbi.ie</a></p>
<p><b>Lista për sigurinë e fëmijëve për ndihmën e parë të Health Service Executive (HSE)</b></p>	<p><a href="https://www.hse.ie/eng/health/child/childsafety/checklist-first-aid.pdf">https://www.hse.ie/eng/health/child/childsafety/checklist-first-aid.pdf</a></p>
<p><b>Health Service Executive (HSE) Lista për sigurinë e Fëmijëve për prindërit e Ekzekutivit të Health Service Executive (HSE) duke përfshirë përshtatjen e shtëpisë për fëmijët</b></p>	<p><a href="https://www2.hse.ie/babies-children/child-safety/at-home/child-proof-your-home/">https://www2.hse.ie/babies-children/child-safety/at-home/child-proof-your-home/</a></p>
<p><b>Mbështetja e Health Service Executive (HSE) Për kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara - Përfitimet dhe të drejtat</b>  <b>(Shërbimi Shëndetësor i Irlandës)</b></p>	<p><a href="https://www2.hse.ie/services/disability-support-and-services/support-for-carers-of-children-with-a-disability/benefits-and-entitlements-for-carers-of-children-with-a-disability.html">https://www2.hse.ie/services/disability-support-and-services/support-for-carers-of-children-with-a-disability/benefits-and-entitlements-for-carers-of-children-with-a-disability.html</a></p>
<p><b>Shërbimet e Health Service Executive (HSE) për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara</b>  <b>(Shërbimi Shëndetësor i Irlandës)</b></p>	<p><a href="https://www2.hse.ie/services/disability-support-and-services/childrens-disability-services/find-a-childrens-disability-service.html">https://www2.hse.ie/services/disability-support-and-services/childrens-disability-services/find-a-childrens-disability-service.html</a></p>
<p><b>Shërbimet dhe Mbështetjet e Health Service Executive (HSE) për Aftësitë e Kufizuara</b>  <b>(Shërbimi Shëndetësor i Irlandës)</b></p>	<p><a href="https://www.hse.ie/eng/services/list/4/disability/">https://www.hse.ie/eng/services/list/4/disability/</a></p>
<p><b>Linja e Ndihmës e Health Service Executive (HSE) për Drogat dhe Alkoolin</b>  <b>(Shërbimi Shëndetësor i Irlandës)</b></p>	<p>Telefon falas: 1800 459 459</p>
<p><b>Shërbimet dhe Mbështetjet e Health Service Executive (HSE) për Shëndetin Mendor</b>  <b>(Shërbimi Shëndetësor i Irlandës)</b></p>	<p><a href="https://www2.hse.ie/services/mental-health/services-search/">https://www2.hse.ie/services/mental-health/services-search/</a>          Telefon: 1800 111 888</p>
<p><b>Qeveria e Irlandës dhe departamentet</b></p>	<p><a href="http://www.gov.ie">www.gov.ie</a></p>
<p><b>ISPCC</b>  <i>(Ofron një gamë shërbimesh drejtpërdrejt për fëmijët dhe familjet)</i></p>	<p><a href="http://www.ispcc.ie">www.ispcc.ie</a></p>

<p><b>Legal Aid Board</b> (Një organizatë e pavarur, me financim publik që ofron ndihmë dhe këshillim juridik civil)</p>	<p><a href="http://www.legalaidboard.ie">www.legalaidboard.ie</a></p>
<p><b>Skema Kombëtare e Kujdesit për Fëmijët</b> (Informacion mbi kujdesin për fëmijët e moshës parashkollore)</p>	<p><a href="https://www.ncs.gov.ie/en/">https://www.ncs.gov.ie/en/</a> +353 1 906 8530 – Aplikimet Universale/Sipas vlerësimit të të ardhurave +353 1 906 8535 – Referimet e sponsorëve</p>
<p><b>National Childhood Network</b> (Ofron mbështetje për sektorin e fëmijërisë së hershme)</p>	<p><a href="https://ncn.ie/parents/">https://ncn.ie/parents/</a></p>
<p><b>National Parents Council</b> (Linjë ndihme dhe shërbime trajnimi për mbështetjen e prindërve në të gjitha aspektet e edukimit të fëmijës së tyre)</p>	<p><a href="http://www.npc.ie">www.npc.ie</a></p>
<p><b>Parentline</b> (Mbështetje për prindërit)</p>	<p><a href="http://www.parentline.ie">www.parentline.ie</a> Telefon: +353 1 8733500</p>
<p><b>Ekipet Rajonale të Arsimit dhe Gjuhës (REALTs)</b> (Për të ndihmuar me vendet në shkollë)</p>	<p><a href="https://www.gov.ie/en/publication/48639-information-for-schools-ukraine/">https://www.gov.ie/en/publication/48639-information-for-schools-ukraine/</a></p>
<p><b>Samaritans Ireland</b> (Një organizatë bamirëse në Irlandë që ofron mbështetje emocionale 24 orë në ditë, 365 ditë në vit)</p>	<p><a href="https://www.samaritans.org/ireland/samaritans-ireland/">https://www.samaritans.org/ireland/samaritans-ireland/</a></p>
<p><b>Tusla, Selia e Agjencisë për Fëmijët dhe Familjen</b> (Agjencia shtetërore përgjegjëse për fëmijët dhe të rinjtë)</p>	<p>Tusla, Selia e Agjencisë për Fëmijët dhe Familjen The Brunel Building, Heuston South Quarter, Saint John's Road West, Dublin 8. D08 X01F Telefon: +353 1 7718500 Email: <a href="mailto:info@tusla.ie">info@tusla.ie</a> <a href="http://www.tusla.ie">www.tusla.ie</a></p>
<p><b>Tusla, Agjencia për Fëmijët dhe Familjen Ekipet e Punës Sociale në Detyrë/Pikat e dedikuara të kontaktit</b></p>	<p><a href="https://www.tusla.ie/get-in-touch/duty-social-work-teams/">https://www.tusla.ie/get-in-touch/duty-social-work-teams/</a></p>

